



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

Manastirliu: Forcojmë mekanizmin e reagimit të institucioneve ndaj dhunës në familje

2017-11-06 15:41:00



Manastirliu: Forcojmë mekanizmin e reagimit të institucioneve ndaj dhunës në familje

Tiranë, 3 Nëntor - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale propozoi sot ndryshime ligjore për forcimin e ligjit "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", në një takim të gjerë konsultativ, ku merrnin pjesë Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, znj. Ogerta Manastirliu, zv/Kryetarja e Kuvendit, znj. Vasilika Hysi, deputete të Kuvendit të Shqipërisë znj. Eglantina Gjermeni, znj. Klodiana Spahiu, znj. Nora Malaj, Ministria e Drejtësisë, znj. Etilda Gjonaj, përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare dhe dhe të shoqërisë civile.

Pse kjo nisëm:

"Vetëm në 9 muajt e parë të vitit 2017 janë regjistruar mbi 3400 denoncime për dhunë në familje, nga të cilat 1940 kërkesa u regjistruan për urdhër mbrojtje. Për fat të keq, 11 persona, 8 prej të cilëve gra, bashkëshorte, nëna...humbën jetën. Në përgjigje të rasteve të shtuara të denoncimit të dhunës në familje, në disa raste me pasoja tragjike, rishikimi i ligjit "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", lindi si një domosdoshmëri për të garantuar mbrojtjen e strukturës së familjes nga dhuna", u shpreh Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, znj. Ogerta Manastirliu.

Çfarë pritet të ndryshojë në ligj me këto propozime:

"Më lejoni të ndaj me ju historinë e një gruaje nga Bulqiza, historinë e Martës, 29 vjeçare, e cila u tërhoq nga kërkesa për urdhrin e mbrojtjes për shkak se nuk kishte mundësi të paguante ekspertët e thirrur nga gjykata! Ajo u tërhoq...Me ndryshimet që ne propozojmë, viktimat e dhunës në familje do të kenë asistencë ligjore dhe avokat falas nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë. Gjithashtu, në ndryshimet ligjore që propozojmë është parashikuar qartësisht detyrimi i të gjitha organeve shtetërore për të ofruar falas çdo shërbim ekspertizë të rasteve të dhunës në familje, ndërsa shpenzimet e ekspertëve që thirren nga gjykata (psikologë, mjekë ligjorë, etj) do të paguhen nga dhunuesi", tha Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Ndryshimet ligjore parashikojnë afate të qarta procedurale, duke filluar që nga regjistrimi i kërkesës e deri te ankimet për vendimet gjyqësore, me qëllim që sidomos urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes të dalin pa asnjë vonesë dhe të sigurojnë viktimën nga rreziku imediat. Pra, vendimi i gjykatës për nxjerrjen e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes do të jetë i formës së prerë dhe nuk do të ankimohet.

Një ndryshim tjetër i propozuar, lidhet me unifikimin e kohës së nisjes së procedurave në rastet e kërkesës për urdhër mbrojtjeje. Gjykata do të duhet të vendosë për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes jo më vonë se brenda 15 ditëve nga regjistrimi i kërkesës.

"Me fokus tek më të pambrojturit, fëmijët, ndryshimet që ne

propozojmë, janë ndryshime që përmirësojnë mbrojtjen e fëmijëve, pasi për herë të parë, me urdhrin e mbrojtjes për nënën, automatikisht do të garantohet urdhri i mbrojtjes për fëmijët, edhe nëse mbi ta nuk është ushtruar dhunë e drejtpërdrejtë. Dua të kujtoj këtu, rastin e Majlindës, një rast i bërë publik, që ju besoj e mbani mend, fëmijët e së cilës kishin asistuar në dhunën e vazhdueshme të të atit ndaj nënës së tyre, e megjithatë, gjykata vendosi kujdestarinë e fëmijëve tek dhunuesi! Raste të tilla nuk do të mund të ndodhin më! Ndryshimi në ligj që ne propozojmë, parashikon qartë se kujdestaria për fëmijët, edhe kur ata nuk kanë qenë objekt i drejtpërdrejtë i dhunës në familje, i kalon automatikisht viktimës të dhunës”, u shpreh znj. Manastirliu.

Një tjetër ndryshim i propozuar lidhet me përcaktimin më të qartë të përgjegjësisë së zyrtarëve në çdo hallkë të zinxhirit të mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje.

Të gjitha institucionet përgjegjëse për masat në mbrojtje të viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare, me qëllim që të rritet efektiviteti i zbatimit të ligjit, që do të propozohet për ndryshim, do të kenë masa administrative (gjoba që varjojnë nga 50-100 mijë lekë) për punonjësit që nuk kryejnë detyrën për pajisjen e viktimës me provat e nevojshme për marrjen e urdhrin të mbrojtjes.

Nën/Kryetarja e Kuvendit, znj. Vasilika Hysi si dhe deputetet znj. Eglantina Gjermeni, znj. Klodiana Spahi dhe znj. Nora Malaj, e mbështetën nismën, duke kërkuar të dërgohen sa më parë në Kuvend këto ndryshime ligjore, për të garantuar mirëfunksionimin e mekanizmit të reagimit të institucioneve, përfshi edhe sistemin e drejtësisë, ndaj dhunës në familje.

Ndryshimet ligjore janë hartuar me ekspertë të fushës dhe pas konsultimeve me të gjithë aktorët e interesit, do të shkojnë për miratim në Kuvend.

###